

VENDIM
Nr.997, datë 2.7.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.371, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 1 shtohet emërtesa “Administrata e Akademisë së Shkencave”.
 2. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Lidhja nr.1/1, që përmendet në pikën 2/1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 4. Lidhja nr.2, që përmendet në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 5. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“4. Paga e grupit, (kolona 1), e lidhjeve nr.1, nr.1/1 e nr.2, “Diplomë e shkollës së lartë”, është 11 000 (njëmbëdhjetë mijë) lekë.”.
 6. Në pikën 5, pas fjalëve “...nr.2...” shtohen f “...e nr.1/1...”.
 7. Paragrafi i parë i pikës 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“6. Shtesa për kualifikim, (kolona 3), e lidhjeve nr.1, nr.1/1 e nr.2, përcaktohet si më poshtë vijon:”.
 8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për politikën e pagave, për vitin 2008.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET QENDRORE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA PËR POZICION
		1	2	3	4
		Paga e grupit	Shtesa vjetore	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion

		(PG)	për vjetërsi (SHV)	(SHK)	(SHP)
Titullari i institucionit	II-a	11 000	2%		103 500
Zv/titullar i institucionit, Drejtor drejtorie	II-b	11 000	2%		86 500
Anëtar i organit drejtues	III-a	11 000	2%		68 500
Përgjegjës sektori, Përgjegjës i bibliotekës shkencore në Akademinë e Shkencave	III-a/1	11 000	2%		58 300
Përgjegjës sektori, Kryetar dege në Akademinë e Shkencave, Inspektor, Redaktor në Akademinë e Shkencave	III-b	11 000	2%		51 500
Asistent seksioni në Akademinë e Shkencave, Bibliografë në Akademinë e Shkencave	IV-a	11 000	2%		39 000
Specialist	IV-a	11 000	2%		39 000
	IV-b	11 000	2%		29 000

LIDHJA NR.1/1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË AGJENCINË
KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

PAGA MUJORE						
POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA PËR POZICION	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
		1	2	3	4	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	
Titullari i institucionit	II-a	11 000	2%		103 500	20 000

Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes	II-b	11 000	2%		86 500	15 000
Drejtor drejtorie në drejtoritë mbështetëse	II-b	11 000	2%		86 500	0
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes	III-a/1	11 000	2%		58 300	20 000
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	III-a/1	11 000	2%		58 300	0
	III-b	11 000	2%		51 500	0
Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes	III-b	11 000	2%		51 500	25 000
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse	IV-a	11 000	2%		39 000	0
	IV-b	11 000	2%		29 000	0

LIDHJA NR.2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË INSTITUCIONEVE RAJONALE/VENDORE, NË VARËSI TË INSTITUCIONEVE QENDRORE NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA PËR POZICION
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
Titullari i institucionit rajonal	III-b	11 000	2%		51 500
Titullari i institucionit vendor Përgjegjës sektori në	IV-a	11 000	2%		39 000

institucionet rajonale					
Përgjegjës sektori i institucionit vendor, Specialist në institucionet rajonale	IV-b	11 000	2%		29 000
Specialist në institucionet vendore	IV-c	11 000	2%		21 500